



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 30 (827885)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 2 gusht 2024

Pirro Vengu, Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë



» faqe 3

Në 24 orët e fundit ka vijuar pa ndërprerje puna për shuarjen e zjarreve në disa zona të vendit. Janë shuar 13 vatra zjarri nga 20 të evidentuara në 24 orët e fundit, mes tyre edhe zjarri në fushën e mbetjeve në qytetin e Vlorës.

Por vijojnë të jenë aktive sot zjarret në fshatin Zogaj, bashkia Tropojë, i cili është izoluar plotësisht në kufi me bashkinë Has, por vijon të jetë aktiv me intensitet të ulët në veri të lagjes Hajdarmataj. Strukturat e pushtetit vendor të mbështetura nga Forcat e Armatosura po vijojnë operacionin në atë zonë.

Po punohet për shuarjen e vatrës në fshatin Hoten, bashkia Vau Dejës. Zjarri ka intensitet të ulët dhe nuk paraqet rrezik për zonat e banuara.

Zjarri në fshatin Mal-Shëngjin, bashkia Lezhë, i cili ishte aktiv prej disa ditësh, dhe pati një përhapje të menjëhershme, duke vënë në rrezik bizneset dhe zonat e banuara. Pas ndërhyrjes nga ajri u bë e mundur shmangia e rrezikut për qytetarët. Vijon të jetë aktiv zjarri në fshatin Zavalinë, bashkia Elbasan, ku janë angazhuar në aksion strukturat e pushtetit vendor të mbështetura nga Forcat e Armatosura.

Puna po vijon edhe në dy vatra të tjera, në kodrat e liqenit të Viroit, në Gjirokastrë dhe fshatin Lozhan, bashkia Maliq. Forcat Zjarrfikëse, mbështetur nga ato të Forcave të Armatosura, Policia e Shtetit, Shërbimi Pyjor, Zonat e Mbrojtura apo edhe forca vullnetare, nën koordinimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile kanë punuar intensivisht në disa fronte për të shuar zjarret e rëna në disa zona të vendit.

Puna ka vijuar përgjatë gjithë natës pa ndërprerje në vatrën problematike në fshatin Mal-Shëngjin, ku situata paraqitet më e stabilizuar. Veç ndërhyrjes së helikopterit “Cougar” nga ajri në mbështetje erdhën edhe dy avionët “Canadair” nga Italia, pjesë e ndihmës nga Mekanizmi Evropian i Mbrojtjes Civile.

Fatmirësisht nuk pati lëndime në njerëz, por vetëm minimale në biznese përreth zonës së zjarrit, në 2 bare plazhi dhe çatia e një shtëpie. Aktualisht është arritur izolimi i plotë i vatrave dhe po vijon operacioni për shuarjen përfundimtare të tij nga shërbimet zjarrfikëse, efektivet e FA-së,



Situata e zjarreve në vend

policisë, strukturat vendore të mbështetura edhe nga 2 avionët “Canadair” të Italisë.

Po ashtu vijon punë për shuarjen e zjarrit në fshatin Zavalinë, bashkia Elbasan për të cilin janë angazhuar ditën e sotme strukturat e pushtetit vendor të mbështetura nga FA.

Aktivë janë zjarri në kodrat e liqenit të Viroit, bashkia Gjirokastrë, zjarri mbi qytetin e Tepelenës, i cili si pasojë e erës së fortë ka dalë jashtë kontrollit.

Janë angazhuar ditën e sotme për normalizimin e situatës strukturat vendore të mbështetura nga Forcat e Armatosura dhe një helikopter i FA-së.

Po punohet në fshatin Lozhan - Bode, bashkia Maliq, në fshatin Picar, bashkia Vorë në një objekt

tregtar, në fshatin Ujanik, bashkia Skrapar. Ndërsa situata në qarqet e tjera paraqitet relativisht e qetë.

3 vatra zjarri janë shuar gjatë 24 orëve të fundit, nga 39 vatra të raportuara. Sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile vijojnë të jenë aktive ditën e sotme zjarret në: fshatin Skuraj, bashkia Kurbin, Malin e Kakarriqit, bashkia Lezhë, fshatin Gjadër, bashkia Lezhë, fshatin Zavalinë, bashkia Elbasan dhe fshatin Kus, bashkia Tiranë. Për shuarjen e plotë edhe të këtyre zjarreve janë duke punuar sot strukturat e pushtetit vendor të mbështetura nga ato në nivel qendror. Aktualisht vatrat nuk paraqesin rrezik për zona të banuara.

Në operacionet e fundit për shuarjen e vatrave

morën pjesë rreth 1400 forca operacionale me 75 mjete si dhe helikopteri “Cougar”.

Ju bëjmë thirrje qytetarëve të raportojnë në kohë në numrat e emergjencave për çdo problematikë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile do të vijojë pa ndërprerje ndjekjen e situatave dhe do të angazhojë të gjitha kapacitetet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Mirënjohje për të gjitha forcat operacionale të angazhuara në këto operacione për shuarjen e zjarreve, një pjesë e të cilave janë shkaktuar qëllimisht nga dora e njeriut.

Ju bëjmë thirrje banorëve të bëjnë kujdes! Ligji është i qartë dhe i rreptë për ata që ndezin zjarre!

Forca Ajrore, angazhim maksimal për izolimin e vatrave të zjarrit

Vijon angazhimi i Forcës Ajrore në situatën e zjarreve, në mbështetje të të gjithë forcave operacionale të angazhuara në terren.

Personeli prej 30 vetash, pilotë, teknikë helikopteri, kontrollorë, personel i shërbimeve mbështetëse, është angazhuar për çdo fluturim, për të siguruar kushtet dhe parametrat e duhura për fluturim e helikopterit “Cougar”, si dhe për izolimin e vatrave të zjarrit në zonat: Shëngjin, Shkodër, Gjirokastrë, Tepelenë.

Ka pasur bashkëpunim edhe me dy avionë, CAN 24/14 italianë, të cilët kanë dhënë ndihmën e tyre në zonat e prekura nga zjarri.

Gatishmëria, angazhimi dhe bashkëpunimi i personelit të Forcës Ajrore ka konsistuar në realizimin e 23 misionëve me rreth 61 orë fluturim dhe hedhjen e rreth 718 kovave ujë.



Z. Pirro Vengu, pas betimit me dorën mbi Kushtetutën e vendit, para presidentit të Republikës Bajram Begaj, merr zyrëtarisht detyrën për drejtimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Detyra iu dorëzua në një ceremoni të veçantë nga ministri paraardhës i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi.

Gjatë fjalës së tij, ministri i ri z. Pirro Vengu, teksa përgëzoi ministrin paraardhës për punën e bërë dhe arritjet në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë u shpreh se: “Ministria e Mbrojtjes është një ministri, e cila në zemrën e saj ka padyshim Atdheun, Detyrën, Nderin, vlera këto, të cilat mëshirohen më së miri qoftë në trupën ushtarake, qoftë në atë civile”.

“Këto, - theksoi më tej ministri, - duhet të na bëjnë më të vetëdijshëm për mundësitë që na jepen, për kontributin që duhet të kemi ndaj atdheut, jo vetëm për mbrojtjen e integritetit të tij, por gjithashtu për të kontribuar në elementë që modernizojnë Forcën tonë të Armatosur dhe na bëjnë realisht një pikë referimi në rajon, i cili po njeh kohë më të turbullta se më parë”.

Ministri Vengu premtoi të vijojë punën e tij me të gjitha energjitë, në funksion të përparësive që ka përcaktuar qeveria shqiptare për FA-të dhe fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Gjatë fjalës së tij, ministri Vengu nënvizoi faktin se efektivë të shumtë të Forcave të Armatosura janë angazhuar këto ditë në emergjencat civile për shuarjen e zjarreve.

Ndërkaq në fjalën e tij përshëndetëse, me rastin e largimit nga detyra, ish-ministri Niko Peleshi shprehu mirënjohjen për ekipin ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes, duke nënvizuar arritjet që Shqipëria ka shënuar si pjesë e Aleancës së NATO-s në këto vite: “Sot Shqipëria është një vend që është ngjitur në vlerësimet e Aleancës sonë, NATO. Sot Shqipëria, është kënaqësi e madhe të shohim, që është renditur ndër vendet e dalluara në NATO për përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve të Aleancës, para vendeve të tjera që janë më herët dhe më para nesh në atë Aleancë, por siç e thashë e gjitha është merita juaj”, - theksoi ish-ministri Peleshi.



Pirro Vengu, Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë



Z. Pirro Vengu ka lindur, më 24 prill 1986, në Elbasan. Përpara se të merrte këtë detyrë, z. Vengu ka mbajtur postin e drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës, duke nisur nga viti 2019. Në periudhën 2017 deri në 2019 ai ka ushtruar funksionin e drejtorit të Antikorrupsionit, në Kryeministri. Ndërsa nga viti 2013 deri në vitin 2017, z. Vengu ka qenë shef në Kabinetin e Ministrisë së Jashtme. Më herët, gjatë viteve 2010 - 2013, z. Vengu ka mbajtur rolin e koordinatorit të programeve kërkimore, European Council on Foreign Relations (Paris, Francë). Në periudhën e vitit 2009 - 2010, ai ka punuar si asistent i programeve, European Council on Foreign Relations, në Paris. Z. Vengu ka kryer studimet në Shkenca Humane, Liceu “Henri IV”; Diplomë e dyfishtë Bachelor në Histori dhe Filozofi, pranë Université Paris Nanterre, (Paris, Francë), në vitin 2008. Në vitin 2010 ka përfunduar master në Histori Politike, pranë Université Paris Nanterre, (Paris, Francë), ndërsa në 2011 ka përfunduar master në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Institut National des Langues et Civilizations Orientales, (Paris, Francë). Z. Vengu është i martuar dhe ka dy fëmijë.

Ministri Vengu ndoqi nga afër situatën e zjarreve në vend

Rreth 120 efektivë të Forcave të Armatosura, forca zjarrfikëse të bashkisë së Tepelenës me mjetet e nevojshme, ndihmuar edhe nga helikopteri i FA-së, u angazhuan në aksionin për shuarjen e zjarrit në fshatin Luzat, bashkia Tepelenë, ku era e fortë përhapri në kohë të shpejtë flakët në një sipërfaqe me bimësi. Ndërhyrja e menjëhershme e forcave bëri të mundur të shmanget rreziku për një nga banesat.

Situatën e ndoqi nga afër vetë ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, i shoqëruar edhe nga prefekti i qarkut Gjirokastrë, Odise Kote dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia. Teksa parashitroi situatën, ministri Vengu tha se është kërkuar edhe bashkëpunimi i banorëve të zonës, në rast se do të kishte evakuime pjesore: “Në një moment patëm vështirësi në përballimin e flakëve që po afroheshin në mënyrë të beftë, por kemi arritur të minimizojmë dëmet. Kemi ndërhyrë edhe me helikopter, duke arritur të kemi një mbulim sa më të mirë të situatës. Në Luzat është bërë një punë mjaft e mirë, janë shpëtuar shtëpitë, të cilat rrezikoheshin. Edhe banorët në këtë fshat kanë bërë një punë shumë të mirë për mirëmbajtjen e tokave të tyre, duke lehtësuar edhe punën dhe përpjekjen e FA-ve për të ndërhyrë apo për të patur akses”, - theksoi ministri Vengu.

Një nga banorët e fshatit falënderoi efektivët që morën pjesë në aksion: “Forcat ishin të shumta



dhe i mposhtën flakët. Më shpëtuan shtëpinë dhe bahçen që kam bërë. Unë masat i kisha marrë, kam bërë brezin e butë rreth e rrotull parcelës që e kam mbjellë me të gjitha llojet e pemëve, por

isha edhe i trembur”, - u shpreh banori. Ndërkaq forcat operationale ndodhen ende në terren, duke vijuar punën për shuarjen e plotë të të gjitha vatrave në këtë zonë.





U zhvillua Konferenca Planëzuese Kryesore “Defender Europe-25”

Forcat e Armatosura në bashkëpunim me Ushtrinë Amerikane për Europën dhe Afrikën (USEUR-AF) zhvilluan Konferencën Planëzuese Kryesore të stërvitjes “Defender Europe-25”, me pjesëmarrjen e 600 përfaqësuesve nga vendet aleate dhe partnere të NATO-s. Në vijimësi të stërvitjeve DEFENDER, përgjatë 2025, Shqipëria do të jetë pjesë e stërvitjes më të madhe të drejtuar nga USEUR-AF, si një mundësi e shkëlqyer për t’u trajnuar dhe vepruar së bashku me vendet aleate dhe partnere, me qëllim forcimin e gatishmërisë operacionale, sigurisë dhe ruajtjes së paqes.



Përfundon montimi i urës metalike tip “Bailey” në fshatin Luzhë, njësia administrative Llugaj, bashkia Tropojë

Banorët e fshatit Luzhë, njësia administrative Llugaj, bashkia Tropojë tashmë do të kenë një urë të re, e cila do t’i vijë në ndihmë banorëve të kësaj zone për të kryer aktivitetet e përditshme, duke e bërë më të lehtë jetesën e tyre dhe duke i ndihmuar për të zhvilluar më tej ekonominë.

Për më shumë se një javë specialistët xhenerë të Batalionit të Xhenios, në Komandën Mbështetëse kanë punuar me përkushtim për montimin e urës metalike tip “Bailey” me gjatësi 15 metra, me seksion 2/1, urë që do të bëjë të mundur lidhjen dhe komunikimin me rrugën kryesore automobilistike.

Komanda Mbështetëse me strukturat vartëse, përmes punës së realizuar në mbështetje të komunitetit, tregon gatishmërinë dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e misionit të saj.



Përfundojnë operacionet EOD, në bashkitë Elbasan dhe Sarandë

Efektivë të kompanisë EOD në batalionin e xhenios u angazhuan në kryerjen e operacioneve në mbështetje të emergjencave civile në bashkitë Elbasan dhe bashkinë Sarandë.

Gjatë punimeve të realizuara për përmirësimin e infrastrukturës në poligonin e qitjes në Detashmentin e Mbrojtjes Rajonale, Mangel janë identifikuar municione të rrezikshme të paplasura. Ekipi i ekspertëve të kompanisë EOD, ka bërë kontrollin, vlerësimin dhe identifikimin e municioneve, të cilat rezultuan të jenë predha artilerie 45 mm. Municionet e gjetura u konsideruan të lëvizshme.

Specialistë të kompanisë EOD, i janë përgjigjur kërkesës së autoriteteve përgjegjëse për vlerësimin dhe largimin e municionit të ndodhur në anijen e peshkimit, ankoruar në portin e Limjanit në Sarandë. Grupi EOD me përgatitjen e duhur profesionale, ka konstatuar se municioni ishte minë detare britanike e prekshme dhe e lëvizshme. Duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik, u bë transportimi dhe magazinimi i municioneve për në ambientet e batalionit të xhenios.

Batalioni i xhenios vazhdon kontributin e tij për pastrimin e territorit nga municionet e paplasura duke i ofruar komunitetit një mjedis dhe jetesë të sigurt.





MAJOR (R) MSC. AGRON BUKAÇI

Integrimi i STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, manualët dhe rregulloret e strukturave të FA-së merr rëndësi të veçantë, sepse vendos standarde të reja veprimi në përputhje me zhvillimet aktuale, të së ardhmes në të gjitha komponentët, kjo do t'i shërbente qëllimit të arritjes së ndërveprimit me Aleancën, mbajtjen në nivelet e kërkuara të ndërveprimit në fushat operacionale, materiale dhe administrative midis llojeve të forcave në FA, si dhe me forcat e shteteve të tjera të Aleancës së NATO-s. Rritja e nivelit të ndërveprueshmërisë, është qëllimi përfundimtar i standardizimit, ku vendet e Aleancës të punojnë me njëri-tjetrin, duke përdorur mjete të teknologjisë të lartë dhe të njohura nga të gjithë anëtarët e Aleancës. Integrimi i STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, manualët dhe rregulloret e strukturave të FA-së, do të vlerësohej si realist, nisur nga niveli i evidentimit, niveli i ratifikimi të STANAG/AP-ve si dhe nga niveli i zbatimi i këtyre STANAG/AP në FA të RSH. Këto STANAG/AP në vetvete përmbajnë standarde të pranuar për t'u zbatuar nga vendi ynë në të cilat përfshihen 9 komponentët e kapaciteteve operacionale të deklaruara për Aleancën, si: Doktrina, Organizimi, Stërvitja, Materialet, Pajisjet, Udhëheqja, Edukimi, Personeli, Infrastruktura.

Integrimi i STANAG/AP-ve duhet t'i shërbejë stërvitjes, ku nëpërmjet krijimit dhe zgjerimit të kapaciteteve ushtarake në FA në të gjithë spektrin e misionit të saj, të sigurojë integrimin efektiv e të ndërveprueshmë brenda forcave të veta dhe me forcat e vendeve aleate në operacione në përgjigje të krizave të drejtuara nga NATO.

Përcaktimi dhe standardizimi i radhës së punës për komandat e Forcave/Drejtoritë në SHPFA dhe repartet mbështetëse të FA-së në iniciimin, dhe përgatitjen e gjithanshme për integrimin e STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, manualët dhe rregulloret e këtyre strukturave të FA-së, më qëllim që doktrinën, manualët dhe rregulloret e përgatitura nga grupet e punës të ngritura nga vetë këto struktura të jenë në përmbajtjen e tyre sa më përafërta me doktrinën, manualët dhe rregulloret e vendeve anëtare të NATO-s, dhe me vlera produktive dhe aplikative të dobishme, në funksion të misionit të FARSH-së.

Çfarë kuptojmë me termin standardizim, sipas konceptit të Aleancës së NATO-s?

Aleanca e NATO-s e përkufizon një STANAG si një "dokument, i krijuar me konsensus dhe i miratuar nga një organ i njohur, që ofron për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime ose karakteristika për aktivitetet ose rezultatet e tyre, që synojnë arritjen e shkallës optimale të qëllimit në një kontekst të caktuar". Ka shumë STANAG që mbulojnë një gamë të gjerë temash, duke përfshirë komunikimin, logjistikën, inteligjencën, trajnimin etj., për shembull STANAG 4586, përcakton standardet për ndërveprimin e sistemeve të të dhënave ushtarake.

Marrëveshja e Standardizimit të NATO-s (STANAG) luan një rol jetik në suksesin dhe efektivitetin e Aleancës së NATO-s, duke lehtësuar ndërveprueshmërinë dhe përputhshmërinë midis forcave ushtarake të vendeve anëtare dhe është një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit, si dhe për arritjen e nivelit të kërkuar të sigurisë dhe besueshmërisë së pajisjeve ushtarake. Aftësia për të punuar së bashku në mënyrë efektive dhe efikase është themeli i suksesit të NATO-s, duke i dhënë Aleancës forcë dhe aftësi të pjesëve të saj. Për të kryer operacione shumëkombëshe, vendet duhet të ndajnë një sërë standardesh të përbashkëta, rregulla ose udhëzime që sigurojnë mirëkuptim të ndërsjellë dhe funksionalitet praktik që mbulojnë çdo gjë, nga përmasat e municioneve, mjetet e blinduara, tanket, avionët, logjistika, ndërlikdhja e deri të gjuha e komunikimit që trupat përdorin për të komunikuar me njëri-tjetrin.

Qëllimi i STANAG-ve

"Qëllimi i STANAG-ve është të lehtësojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet vendeve anëtare të NATO-s, veçanërisht në kohë krize ose konflikti". Standardizimi i NATO-s është zhvillimi dhe zbatimi i koncepteve, doktrinave dhe procedurave, për të arritur dhe ruajtur nivelet e kërkuara të përputhshmërisë, këmbësueshmërisë ose të përbashkëtave të nevojshme për të arritur ndërveprueshmërinë.

Aleanca e NATO-s, ku bën pjesë edhe vendi ynë është një Aleancë politiko-ushtarake e themeluar mbi vlera të përbashkëta dhe e bazuar në konsensusin e vendeve anëtare të saj. NATO, për të përmbushur misionin e saj si strukturë e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive, punon vazhdimisht për arritjen dhe zbatimin e politikave, ngushtësisht dhe në mënyrë korrekte midis strukturave, forcave dhe burimeve kombëtare, shumëkombëshe

Integrimi i STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të ndërveprimit në FA dhe vendet e Aleancës së NATO-s



nga bashkëpunimi si një nga rrugët kryesore për arritjen e ndërveprimit të forcave të vendeve të NATO-s të cilat realizohen nëpërmjet procesit të standardizimit.

Një përshkrim i përgjithshëm për standardizimin dhe gjithçka e procesit në FA

Procesi i standardizimit në FA të RSH është procesi nëpërmjet të cilit FA-të zhvillojnë dhe mbajnë kapacitete operacionale të ndërveprueshme midis forcave dhe njësive të tyre si dhe me njësitë e vendeve të NATO-s në fushat e operacioneve, të procedurave, të materialeve si dhe ato teknike dhe administrative. Në këtë kontekst, standardizimi është një nga shtyllat kryesore të suksesit të operacioneve të FA dhe i operacioneve të drejtuara nga Aleanca.

Është synuar zhvillimi i një sistemi funksional të standardizimit në FARSH. Nëpërmjet këtij sistemi eficient të standardizimit në FA synohet që të orientohen autoritetet e komandim-drejtimit dhe komunitetin e standardizimit në FA, për zbatimin

e rregullave standarde të përbashkëta në procesin e inicimit, vlerësimit, ratifikimit, zbatimit dhe rishikimit të standardizimit në FA, sipas përvojës në interes të realizimit të misionit të FA-ve si dhe arritjen e një ndërveprueshmërie sa më të mirë me vendet e Aleancës.

Standardizimi është një proces kompleks dhe gjithëpërfshirës. Për ta zhvilluar në mënyrë të konsoliduar standardizimin në FA është e domosdoshme një bazë ligjore, ku do të bazohet ecuria e procesit të standardizimit në FA.

Dokumenti bazë në nivelin e zhvillimit të politikave të standardizimit për ngritjen e një sistemi funksional të standardizimit në FA është Direktiva e Standardizimit në FA, e miratuar nga Ministri i Mbrojtjes. Direktiva e Standardizimit në FA bazohet në Politikën e NATO-s për Standardizimin, në kuadrin ligjor dhe dokumentet bazë kombëtare të standardizimit. Direktiva e Standardizimit në FA shpreh qëllimin, objektivat dhe përparësitë e standardizimit në FA për arritjen e standardizimit në fushën operacionale, materiale dhe administrative. Ajo orienton gjithashtu komponentët e saj, fushat kryesore, nivelet, si dhe statuset e standardizimit të pranuar në FA. Dhe së fundi, ajo jep strukturat përgjegjëse të përhershme dhe ad-hoc, si dhe detyrat e tyre në funksionimin e sistemit të standardizimit.

Përafrimi me standardet e NATO-s do të arrihet nëpërmjet ratifikimit, pranimit dhe zbatimit të STANAG/AP-ve, ratifikimi dhe pranimi i çdo STANAG/AP për t'u zbatuar në FA shoqërohet me implikime në personel, në doktrina, manuale dhe rregullore, në strukturat e FA-së, infrastrukturës, trajnimit, pajisjeve dhe sistemeve.

Procesi i standardizimit në FA ka kaluar në disa faza vit pas viti. Në vitin 2009 filloi ngritja e sistemit të standardizimit në FA të RSH, për këtë qëllim u ndërmorën disa hapa si: U përgatit dhe u miratua Direktiva e Standardizimit, Manuali i Standardizimit në FA; U ngritën strukturat dhe filloi trajnimi i personelit, i cili do të menaxhonte procesin e standardizimit në FA; U miratua ngritja e Bordit të Standardizimit në FA; U bënë plane vjetore dhe afatmesme 2009-2015, ku u planifikua miratimi i një pakete prej 200 STANAG/AP prioritar.

Viti 2010 shënon fillimin e ratifikimit dhe zbatimit të STANAG/AP-ve, ku u parashikua ratifikimi i 30 STANAG/AP-ve prioritar për FA-të, ku prioritet ka qenë ratifikimi i STANAG/AP-ve që lidhen me Objektivat Afatmesme të Forcës (FG) dhe të Grup Batalionit për pjesëmarrje në operacionet e drejtuara nga NATO.

Procesi i standardizimit në FA ka vazhduar ecurinë e tij vit pas viti, duke ratifikuar STANAG/AP nga Bordi i Standardizimit në FA bazuar në kërkesat e strukturave të FA për ratifikim të STANAG/AP-ve në interes të përmbushje së misionit të tyre.

Sistemi i standardizimit në Forcat e Armatosura dhe komponentët e tij:

- Komponentët e sistemit të standardizimit
- Nivelet e standardizimit në FA
- Fushat e standardizimit
- Statuset e ratifikimit të STANAG/AP-ve
- Zgjerimi i informacionit
- Zbatimi dhe rishikimi i STANAG-ut
- Gjuha e STANAG/AP-ve

dhe të vendeve anëtare. "Marrëveshja e Standardizimit të NATO-s (STANAG) është një grup standardesh dhe procedurash që përdoren nga vendet anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) për të garantuar ndërveprimin dhe përputhshmërinë midis forcave të tyre ushtarake, me synim përfundimin e një detyre ose një serie detyrash". Kjo i ndihmon ata që janë të përfshirë në detyrë të kuptojnë mënyrën më të mirë për ta përfunduar atë. Standardizimi u lejon vendeve të ndryshme të punojnë me njëri-tjetrin, duke përdorur mjete të një standardi dhe të njohura nga vendet e përfshira në operacion.

Standardizimi ndihmon forcat e aleatëve dhe partnerëve të NATO-s të arrijnë ndërveprueshmërinë, duke lejuar përdorimin më efikas të burimeve të mbrojtjes, si dhe duke rritur efektivitetin operacional të Aleancës. Në terma praktikë, standardet u mundësojnë njerëzve nga një shumëllojshmëri e gjerë vendesh të ndryshme të kenë pajisje të përputhshme, të kuptojnë metodat dhe procedurat e njëri-tjetrit dhe të funksionojnë pa probleme edhe nëse sapo kanë filluar të punojnë së bashku. Kjo quhet ndërveprueshmëri, që është edhe qëllimi përfundimtar i standardizimit.

Standardizimi

Standardizimi është procesi i zhvillimit, promovimit dhe mundësisht detyrimit të teknologjive dhe proceseve të bazuara në standarde dhe të përputhshme brenda një industrie. Standardet e teknologjisë fokusohen në sigurimin e cilësisë, qëndrueshmërisë, përputhshmërisë, ndërveprueshmërisë dhe sigurisë.

Standardizimi përfshin normalizimin e qasjeve të personalizuar më parë ose të ndryshme ndaj proceseve dhe teknologjisë. Ai ofron rregulla, procese, udhëzime, shabllone, statistika dhe të dhëna të tjera për të vendosur dhe zbatuar cilësi dhe konformitet të qëndrueshëm në mënyrën se si duhet të ndodhin aktivitetet specifike brenda një mjedisi. Standardet përdoren pothuajse me të gjitha teknologjitë, ata sigurojnë që të gjithë lojtarët në një industri të ndërtojnë produkte dhe shërbime dhe të kryejnë aktivitete në mënyrë të vazhdueshme dhe në përputhje me rregullat dhe udhëzimet specifike. Standardizimi është inovacion, duke e konsideruar të tillë ka sjellë dhe do të sjellë risi në FA, duke rritur kështu performancën e strukturave tona të FA.

Në këtë kontekst, ndërveprimi dhe standardizimi i forcave të vendeve të Aleancës për misione të përbashkëta përbën një çështje të rëndësishme prioritarë. Duke qenë se Aleanca përbëhet nga 30 vende anëtare dhe se ajo shkon në operacione edhe së bashku me vendet të tjera të iniciativës PfP dhe partnerë të tjerë globalë, një nga elementet kryesore të suksesit të saj edhe në të ardhmen mbetet ndërveprimi i forcave ushtarake në operacione. Aleatët duhet të jenë të ndërveprueshëm me njëri-tjetrin dhe, kur kërkohet kjo me vendet partnere, me shtetet e tjera, si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare dhe departamentet tjera qeveritare (departamente jo të mbrojtjes) e bazuar në doktrinën dhe rregullat e përbashkëta të vendeve anëtare të saj.

Ky ndërveprim i forcave të Aleancës arrihet nëpërmjet procesit të përafrimit nga vendet anëtare të saj në fushën e doktrinave, të organizimit, të trajnimit dhe stërvitjes, të arsimimit, të pajisjeve dhe sistemeve, strukturave dhe infrastrukturave, si dhe aspekteve të shumta të veprimtarisë së Aleancës.

Arritja e objektivave të Aleancës varet gjithnjë e më shumë

Të vetëdijshëm, të aftë dhe të angazhuar për një të ardhme më të sigurt, Politikat e NATO-s mbi Kundër-Terrorizmin

Terrorizmi është kërcënimi asimetrik më i drejtpërdrejtë për sigurinë e qytetarëve të vendeve të NATO-s dhe për stabilitetin dhe prosperitetin ndërkombëtar. Një çështje globale e vazhdueshme që nuk njihet kufi, kombësi apo fe, terrorizmi është një sfidë që komuniteti ndërkombëtar duhet ta trajtojë së bashku. NATO do të vazhdojë ta luftojë këtë kërcënim me vendosmëri dhe solidaritet të plotë. Puna e NATO-s për kundër-terrorizmin përqendrohet në përmirësimin e ndërgjegjësimit për kërcënimin, zhvillimin e aftësive për t'u përgatitur dhe përgjigjur, si dhe në rritjen e angazhimit me vendet partnere dhe aktorë të tjerë ndërkombëtar.

Në Samitin e NATO-s, në Uashington, krerët e shteteve dhe qeverive miratuan Udhëzimet e përditësuara të Politikës së Aleancës për Kundër-Terrorizmin. Këto Udhëzime pasqyrojnë evolucionin e kërcënimit të terrorizmit dhe të punës së NATO-s për të luftuar terrorizmin gjatë dekadës së fundit.

Udhëzimet e përditësuara të politikave fokusojnë punën e NATO-s kundër terrorizmit në tre fusha kryesore: përmirësimi i ndërgjegjësimit për kërcënimin terrorist; sigurimin e aftësive dhe gatishmërisë adekuate; dhe rritjen e angazhimit dhe bashkëpunimit me vendet partnere të NATO-s dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Krerët e shteteve dhe qeverive përsëritën dhe rafinuan gjithashtu parimet kryesore të luftës së Aleancës kundër terrorizmit: pajtueshmërinë me të drejtën ndërkombëtare, mbështetjen për aleatët dhe mos dyfishimin dhe plotësimin.

Në margjinat e Samitit të Uashingtonit, Udhëzimet e përditësuara të Politikës dhe implikimet e tyre për punën e NATO-s, për të luftuar terrorizmin, u përshkruan nga Koordinatori Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kundër-Terrorizmin, Tom Goffus, në një sesion të Forumit Publik të NATO-s, të titulluar “Adresimi i Kërcënimit në Zhvillim të Terrorizmit”. “Dokumenti ynë më i rëndësishëm pas Traktatit të Uashingtonit është Koncepti Strategjik”, - deklaroi ai, duke reflektuar se terrorizmi është kërcënimi më i drejtpërdrejtë asimetrik për sigurinë e qytetarëve dhe për paqen dhe prosperitetin ndërkombëtar. “Tani kemi plane mbrojtëse si për Rusinë ashtu edhe për terrorizmin... ne kemi planet më të detajuara që kanë ekzistuar ndonjëherë për terrorizmin”, - tha ai.

Udhëzimet e Politikës së NATO-s për Kundër-Terrorizmin

Udhëzimet e politikës së NATO-s kundër terrorizmit fokusojnë përpjekjet e Aleancës në tre fusha kryesore: ndërgjegjësimi, aftësitë dhe angazhimi.

Ndërgjegjësimi

Në mbështetje të autoriteteve kombëtare, NATO siguron ndërgjegjësim të përbashkët për kërcënimin terrorist nëpërmjet konsultimeve, ndarjes së zgjeruar të inteligjencës dhe analizave dhe vlerësimeve të vazhdueshme strategjike.

Raportimi i inteligjencës në NATO bazohet në kontributet e shërbimeve të inteligjencës së Aleatëve, si të brendshme ashtu edhe të jashtme, civile dhe ushtarake. Mënyra se si NATO trajton informacionin e ndjeshëm ka evoluar gradualisht bazuar në vendimet e samiteve të njëpasnjëshme dhe reformën e vazhdueshme të strukturave të inteligjencës që nga viti 2010.

Ndarja e inteligjencës ndërmjet NATO-s dhe agjencive të vendeve partnere vazhdon përmes Njësisë së Ndërlidhjes së Inteligjencës në Selinë e NATO-s në Bruksel dhe një celulë ndërlidhëse të inteligjencës në Komandën Aleate të Operacioneve (ACO) në Mons, Belgjikë. Një qelizë e inteligjencës në selinë e NATO-s përmirëson mënyrën se si NATO ndan informacionin, duke përfshirë luftëtarët e huaj.

NATO përballet me një sërë kërcënimesh që vijnë nga destabiliteti në rajon në jug të Aleancës. NATO rrit të kuptuarit e saj për këto sfida dhe përmirëson aftësinë e saj për t'u përgjigjur atyre përmes “Hub for the South” me bazë në Komandën e Forcave të Përbashkëta të NATO-s në Napoli, Itali.

Duke njohur shumë role të ndryshme që burrat dhe gratë mund të luajnë në grupet terroriste, NATO po kërkon gjithashtu të integrojë një perspektivë gjinore në të gjitha përpjekjet e saj kundër terrorizmit, duke përfshirë trajnimin dhe edukimin për aleatët dhe partnerët, si dhe zhvillimin e politikave dhe programeve. Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg njoftoi pozicionin e Koordinatorit Special për Kundër-Terrorizmin në tetor 2023. Koordinatori Special për Kundër-Terrorizmin shërben si pikë qendrore e nivelit të lartë për të gjithë punën e NATO-s në luftën kundër terrorizmit dhe siguron që përgjigja e NATO-s ndaj terrorizmit të mbetet i fortë, efektiv dhe koherent. Koordinatorin e posaçëm aktual është Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm për Operacionet Tom Goffus.

Aftësitë

Aleanca përpigjet të sigurojë që ka aftësitë e duhura për të parandaluar, mbrojtur dhe për t'u përgjigjur kërcënimeve terroriste. Zhvillimi i aftësive dhe puna mbi teknologjitë inovative janë pjesë e çështjes kryesore të NATO-s dhe metodat që trajtojnë kërcënimet asimetrike, duke përfshirë terrorizmin dhe përdorimin e armëve jokonvencionale, janë të një rëndësie të veçantë. Pjesa më e madhe e kësaj pune kryhet përmes Programit



Një specialist i Asgjësimit të Mjeteve Eksplozive të Ushtrisë Polake (EOD) ecën drejt një mjeti shpërthyes të dyshuar të improvizuar (IED) gjatë “Sfidës Veriore”, një stërvitje shumëkombëshe që zhvillohet në objektin e Rojës Bregdetare Islandeze në Keflavík, Islandë.

të Punës Mbrojtja kundër Terrorizmit, i cili lehtëson zhvillimin e aftësive për të mbrojtur forcat e NATO-s, civilët dhe territorin kundër sulmeve nga terroristët. Qendrat e Përsosmërisë së NATO-s (COE) janë kontribues të rëndësishëm në shumë projekte, duke ofruar ekspertizë në një sërë temash, duke përfshirë shfrytëzimin teknik, provat e fushëbetejës, asgjësimin e mjeteve shpërthyes, inxhinierinë ushtarake, kundër-IED dhe analizën dhe modelimin e rrjetit.

Politikat e NATO-s dhe kornizat praktike në fusha të tilla si C-UAS, biometria, provat e fushëbetejës dhe shfrytëzimi teknik nxisin gjithashtu zhvillimin e aftësive në fusha të rëndësishme për kundër-terrorizmin.

Programi i Punës i Mbrojtjes Kundër Terrorizmit

Programi i Punës i Mbrojtjes Kundër Terrorizmit (DAT POW) u zhvillua nga Konferenca e Drejtorëve Kombëtarë të Armatimeve (CNAD) dhe u miratua nga Liderët e NATO-s në Samitin e Stambollit në 2004. Me fokus fillestar në zgjidhjet teknologjike për të zbutur efektet e sulmeve terroriste, që atëherë programi ka zgjeruar fushëveprimin e tij për të mbështetur zhvillimin gjithëpërfshirës të aftësive. Ai tani përfshin ushtrime, prova, zhvillimin e prototipave dhe koncepteve, doktrinën, politikën, pajisjet, trajnimet dhe mësimet e nxjerra dhe demonstrimet e ndërveprimit. Qëllimi kryesor i DAT POW është të parandalojë sulmet jo-konvencionale, të tilla si sulmet me IED dhe UAS, dhe të zbusë sfidat e tjera, të tilla si sulmet në infrastrukturën kritike dhe përdorimi i teknologjive në zhvillim dhe përçarës nga terroristët.

DAT POW bazohet në parimin e financimit të përbashkët, ku vendet anëtare bashkojnë burimet brenda kornizës së NATO-s. Sipas DAT POW, vende individuale të NATO-s, me mbështetje dhe kontribute nga vende të tjera anëtare dhe organe të NATO-s, udhëheqin projekte për të zhvilluar teknologji të avancuara ose kundërmasa që plotësojnë nevojat më urgjente të sigurisë përballë terrorizmit dhe kërcënimeve të tjera asimetrike.

Shumica e projekteve në kuadër të programit fokusohen në gjetjen e zgjidhjeve që mund të vihen në terren në afat të shkurtër dhe që u përgjigjen nevojave ushtarake të Aleancës – edhe pse POW DAT lidh gjithashtu hendekun midis kërkesave ushtarake afatgjata dhe nevojave urgjente operacionale. Programi përdor teknologji ose metoda të reja ose të përshtatura për zbulimin, prishjen dhe mposhtjen e kërcënimeve asimetrike, duke mbuluar një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë luftimin e sistemeve të avionëve pa pilot (C-UAS), biometrikën, shfrytëzimin teknik dhe përbashkimin e pajisjeve shpërthyes të improvizuara (C-IED). DAT POW është një kontribues integral i aktiviteteve të NATO-s në fushën e teknologjive në zhvillim dhe përçarëse, të tilla si të dhënat, inteligjenca artificiale dhe sistemet autonome dhe teknologjitë mund të përdoren në luftën kundër terrorizmit.

Operacionet dhe misionet

Si pjesë e qasjes 360 shkallë të Aleancës për parandalimin dhe mbrojtjen, përpjekjet kundër terrorizmit të NATO-s, shtrihen përmes një sërë operacionesh dhe misionesh, si brenda territorit të NATO-s ashtu edhe përtej kufijve të Aleancës.

Që nga viti 2017, NATO ka qenë anëtare e Koalicionit Global për të mposhtur ISIS-in. Si anëtare e Koalicionit, NATO ka luajtur një rol kyç në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, duke përfshirë angazhimin e saj të mëparshëm operacional në Afganistan, përmes shkëmbimit të inteligjencës dhe përmes punës së saj me partnerët me synimin për të projektuar stabilitetin në Zonën Euroatlantike dhe më gjerë. Në Samitin e NATO-s të vitit 2016 në Varshavë, Udhëheqësit Aleatë ranë dakord të ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për Koalicionin Global përmes ofrimit të avionëve vëzhgues të NATO-s AWACS. Patrullat e para të avionëve AWACS të NATO-s, që operojnë nga aeroporti Konya në Turqi, filluan në tetor 2016.

Në shkurt 2018, pas një kërkesë të qeverisë irakiane dhe Koalicionit Global, Aleanca vendosi të nisë misionin e NATO-s në Irak, një mision këshillimor jo-luftarak dhe ngritje kapacitetesh. Qëllimi i tij është të forcojë forcat dhe institucionet irakiane të sigurisë në mënyrë që ata të jenë më në gjendje të parandalojnë kthimin e Daesh/ISIS, të luftojnë terrorizmin dhe të stabilizojnë vendin. Në shkurt 2021, Ministrat e Mbrojtjes Aleate dhe në gusht 2023 Këshilli i Atlantikut të Veriut, ranë dakord të zgjerojnë fushën e misionit me kërkesë të qeverisë irakiane. NATO vepron në respekt të plotë të sovranitetit dhe integritetit territorial të Irakut, dhe koordinon dhe konsultohet ngushtë me partnerë të tjerë ndërkombëtarë si Koalicioni Global, Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

NATO gjithashtu merr pjesë në luftën kundër terrorizmit në det të hapur. Operacioni i NATO-s “Sea Guardian” është një operacion fleksibël i sigurisë detare që është në gjendje të kryejë të gjithë gamën e detyrave të sigurisë detare, duke përfshirë edhe luftën kundër terrorizmit në det, nëse kërkohet.

Shumë operacione të tjera kanë pasur lidhje me përpjekjet ndërkombëtare kundër terrorizmit. Për shembull, Forca Ndërkombëtare e Asistencës për Sigurinë (ISAF) - operacioni i udhëhequr nga NATO në Afganistan, i cili filloi në 2003 dhe përfundoi në 2014 - ndihmoi qeverinë të zgjerojë autoritetin e saj dhe të zbatojë sigurinë për të parandaluar që vendi të bëhet sërish një strehë e sigurt për terrorizmin ndërkombëtar. Pas përfundimit të ISAF-it, NATO-ja nisi Misionin Jo-luftarak “Resolute Support” (RSM) për të trajnuar, këshilluar dhe ndihmuar forcat afgane të sigurisë. Në prill 2021, aleatët vendosën të fillonin tërheqjen e forcave të RSM deri më 1 maj 2021 dhe misioni u ndërpre në fillim të shtatorit 2021.

Nevoja e një lidërshipi të mirë në kushtet e sotme



SAKIP CAMI

(Shënime rreth librit studimor: “Lidershipi në mjedisin e sigurisë”, të Dr. gjeneralmajor Manushaqe Shehu)

Disa fjalë për autore

Dr. Gjeneralmajor Manushaqe Lami Shehu është bijë e fisit Lami të fshatit Sohodoll të Dibrës, lindur në Peshkopë, më 5 nëntor 1965, e martuar me ish-deputetin e Kuvendit të Shqipërisë, Sali Shehu, nënë e dy fëmijëve. Ka kryer Akademinë Ushtarake në Tiranë, Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, fakultetin e drejtësisë dhe disa kurse e specializime në Akademitë e vendeve të NATO-s, si në SHBA, Britaninë e Madhe, Francë, Gjermani, Turqi etj.

Është e vetmja grua në Shqipëri që mban gradën “Gjeneralmajor” dhe për dy mandate në detyrën e Zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH. Është gjithashtu Doktore e Shkencave në fushën e sigurisë.

Disa refleksione për monografinë studimore “Lidershipi në mjedisin e sigurisë”

Ish-Presidenti Alfred Moisiu në parathënien e këtij libri nënvizon se studimet në fushën e lidërshiptit të mjedisit të sigurisë në literaturën vendase janë të pakta, ndaj mund të them pa mëdyshje se libri “Lidershipi në mjedisin e sigurisë”, i Gjeneralmajor Manushaqe Shehut, përbën jo vetëm një kontribut, por edhe një rast të veçantë të trajtimit të problemit të drejtuesit ushtarak.

Ky libër shfrytëzon literaturën më të mirë botërore dhe atë kombëtare, e gërsheton me përvojën e gjatë të autores dhe të vetë ushtrisë sonë ndër vite e shekuj dhe arrin të bëhet një manual i shkëlqyer për çdo drejtues ushtarak e civil që kërkon të evidentohet si lider. Jo rastësisht liderë të mëdhenj botërorë si Ajzenhaueri, De Goli e shumë të tjerë kanë qenë gjeneralë ushtarakë.

Evidentohet mjaft mirë në Shqipëri drejtimi si president republike i Gjeneral Alfred Moisiut në vitet 2002-2007.

Ka ndodhur kjo se është vetë shkolla e ushtrisë si teori dhe praktikë, si veprimtari me shembull personal e me betim atdhetar që përgatit njerëz, kuadro e udhëheqës që lënë gjurmë.

Në pjesën e parë të librit, në kapitullin: “Lidershipi dhe menaxhimi i sigurisë” trajtohen konceptet për figurën e liderit, roli i diplomacisë në fushën e sigurisë, jo për të bërë lëshime por për të përfutur resurse për vendin tënd, trajtohen traditat dhe ligjet e trashëguara si dhe nevoja aktuale për të hartuar e miratuar ligje e plane strategjike, realë në përputhje me gjeopolitikën ballkanike, europiane e botërore.

Trajtohen parimet e drejtimit dhe cilësitë e liderit, komandantit ushtarak, duke vënë theksin në mirë menaxhimin e krizave dhe fatkeqësive natyrore.

Një lider nuk mund të jetë i suksesshëm pa një komunikim perfekt dhe njerëzor, pa një etikë në komunikim dhe kjo kërkon përveç formimit profesional edhe njohuri të plota në pedagogji dhe psikologji, për të arritur në botën e brendshme të njerëzve që



STUDIMET NË FUSHËN E LIDERSHIPIT TË MJEDISIT TË SIGURISË NË LITERATURËN VENDASE JANË TË PAKTA, NDAJ MUND TË THEM PA MËDYSHJE SE LIBRI “LIDERSHIPI NË MJEDISIN E SIGURISË”, I GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHUT, PËRBËN JO VETËM NJË KONTRIBUT, POR EDHE NJË RAST TË VEÇANTË TË TRAJTIMIT TË PROBLEMIT TË DREJTUESIT USHTARAK.

drejtton e komandon. Kryefjala e një lideri në paktet për sigurinë është konsensusi, theksohet në pjesën e tretë të këtij libri.

Strukturat e sigurisë kombëtare, të ndërthurura dhe të drejtuara nga një drejtues strategjik me dimension njerëzor janë të destinuara të funksionojnë si një sahat i vërtetë. Në kushtet e sotme të konflikteve në Ballkan, Europë dhe në botë, roli i liderit merr rëndësi të veçantë. Nuk bëhet fjalë për lider të fortë autokrat, por për lider vizionar, që të marrë vendime të forta në favor të paqes, lirisë, të të drejtave të njeriut dhe mbi të gjitha në

mbrojtje e prosperitet të vendit e të popullit të tij, që i ka dhënë të drejtën dhe besimin për ta drejtuar.

Në botë, në Europë, Shqipëri e Kosovë njihen gra të zonja liderë, që kanë lënë gjurmë pozitive gjatë veprimtarisë së tyre. Gruaja lidere, si nënë, si bashkëshorte, si motër, si shoqe mishëron më së miri dhe ka brenda vetes aftësi të mëdha drejtuese. Autorja e këtij libri, gjeneralmajor Manushaqe Shehu ka përfaqësuar dhe përfaqëson vlerat më të mira të ushtrisë shqiptare dhe jo vetëm të ushtrisë, por edhe të mbarë kombit tonë.

KOLONEL MAMAN SALIU, BURRË I STËRRALLTË I LABËRISË




Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Përgatitur në kuadrin e përkujtimit të figurave të spikatura të atdhetarisë dhe shqiptarizms, me rastin e 80-vjetorit të çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashistë. Mirënjohje për kolonelin e mençur Maman Saliu me rrënjë e degë atdhetare, për kontributin e shquar për trimëri gjatë LANÇ-it dhe më tej në strukturat e sigurisë së brendshme, bir i një oxhaku të madh që i bën nder kombit dhe çështjes shqiptare, për nderimin që i ka bërë historisë me “Kujtime e mbresa”.

Një thes me vite në kurriz, thonë në Labëri dhe për ta shtyrë edhe më tej maksimën popullore: “fjalët me vend i flet i vuajturi, jo i dituri, sepse i dituri flet atë çfarë ka lexuar, i vuajturi flet atë çfarë ka kaluar”. Në qarkullim prej dy vjetësh është libri i një figure sojli fisnik, të përmasave që bindshëm i ka shërbyer kombit. Është e vërtetë shprehja e latinëve të vjetër se “librat kanë fatin e tyre”, por është po kaq reale maksima labe se, “ku ka rrjedhur do pikojë, do vejë soji në soj”.

Maman Saliu me publikimin “Kujtime dhe mbresa”, ka derdhur në letër kujtimet e tij jo me të thënë, por të jetuara në tre epoka, ka shkruar qartë, me fjalë të lara në dritë dielli pa zbukurime e dafina, thjeshtë bindshëm. Në librin e tij lexojmë një copëz të historisë shqiptare, lexojmë fitimtarët e luftërave, lexojmë historinë pa rotacion pushteti, lexojmë vlerat morale të një populli të shumëvuajtur të hallemadhes sonë shekullore. Frazat e librit janë të ngjyera në muzën poetike labe, pena e tij është ngjyer në gjakun e dëshmorëve dhe nuk flet një njeri, por një ikonë e patriotizmit shqiptar. Ai shpreh qartë edhe kërkesën e bashkëluftëtarëve të llogoreve partizane si Halim Ramohitua, kur i drejtohej Maman Saliut: “Shkundu o ujk i vjetër i luftës dhe i punës, i pushkës dhe i penë për çlirimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e këtij vendi dhe këtij populli. Është momenti që të hedhësh në letër rezervat që ke akoma në këtë fushë, kujtimet që të kanë mbetur... se jemi drejt rrugës pa kthim...”. Maman Saliu i dëgjonte shokët, por dhe zërin e ndërgjegjes, dhe nëse gjithkush që bëri luftën do të “shkundej”, do të kishim sot jo qindra, por mijëra libra të luftës antifashiste të shqiptarëve, fitimtarëve të saj, nuk kishte gjyle të luante themelet e LANÇ-it, përfshi këtu edhe tellallët e neofashistëve që tentojnë edhe me mekanizma shtetërorë të pushtetit të sotëm të baltosin e sfidojnë pasardhësit e fitimtarëve të Luftës Antifashiste. Kjo nuk mund të ndodhë edhe sikur të shuhet drita e diellit! Në 638 faqe në të katër pjesët e tij gjendet jeta, epokat, lufta me “një mbret i 40 milionë”, lëvizja antifashiste, gjaku për liri, rrugëtimi mijëra kilometra të përgjakshme ballë për ballë me bishën nazifashiste, lufta përtej kufijve, plagë të shumta lufte, shokë të vrarë për idealet, me mision në Jugosllavi, në kërkim të eshtrave të shokëve, kontributi për ngritjen e vendit, kohë bandash që terrorizonin popullsinë, vitet e Moskës në portat e dijes, shkollimi brenda e jashtë vendit, person “non grata”, sfida e përgatitjes së oficerëve në Sauk, kuvendim me Labërinë dhe në zemër të saj, portrete, vlerësime, refleksione, mirënjohje.

Një libër memorial i shqiptarizms e kolonel Maman Saliut
Në libër nuk mungojnë edhe impresionet për kujtimet e Maman Saliut, “1000 ditët e luftës së Maman Saliut”, “Në mbrojtje të së vërtetës”, “Libër që evokon një epope të pavdekshme”, “Brezat do ta kërkojnë këtë libër”, “Libër plot singëritet”, “Një libër që nuk flet për ‘unin’”, “Dokument i mirëfilltë historik”, “Fakte mbresëlënëse”, “Trokitje në kujtesë, trokitje në zemrat tona”, “Libër i arrirë në çdo këndvështrim”, “Luftëtar i ndershëm dhe konsekuent”, “Trimi me pushkë e me penë”, “Histori e shkruar me gjak”, “Mozaik ngjarjesh dhe faktesh nga lufta”, “Mesazh dashurie dhe fisnikërie”, “Kontribut për të vërtetën”, “Libër me dimensionet e gjera”. Fakt është se personalitete të shumtë që i referohen Maman Saliut, janë pena të spikatura shqiptare si Dritëro Agolli, Mark Dodani, Luan Rama, Nuredin Dushani, Rustem Peçi, Shaban Sinani, Ramiz Alia, Anastas Kondo, Lirim Deda, Apostol Duka, Halim Ramohito, Vito Kapo, Mikado Shakohoxha, Pavllo Gjidede, Jonuz Mersini, Irfan Bregu, Duro Mustafai, Manxhar Binaj, Xhafer Peçi, Rrahman Parllaku, Kujtim Micaj, Gëzim Tushi, Xhevdet Shehu, Rami Memushaj, Ruzhdi Bajrami dhe shumë të tjerë. Lexuesi që ka marrë në dorë “Trokitje në kujtesë” 2004, “Në vorbullën e jetës”, 2007 si dhe “Kujtime dhe mbresa” të 2022 të



Maman Saliut, ka gjithmonë për të thënë fjalën e vet, për një libër solid, një copëz historie labe dhe shqiptare, që kurrësi nuk mund të jetë një stoli bibliotekash, por një histori me detaje jete të jetuar dhe të shprehur bukur me një gjuhë të pastër dhe të rrjedhshme, një libër i rrjedhshëm i konsultuar me vetë jetën labe, me jetën ushtarake, me vitet e luftës dhe të punës, me vitet e shkollimit në Moskë, një libër i mbushur me plagë lufte, me gjak dëshmorësh, me memorialë e lapidarë të shqiptarizms.

Materializimi më i mirë i maksimës popullore labe: “Bëmë Baba të të ngjaj”

Maman Saliu nuk e njohu babanë, por Sali Vranishtin e njëjtte historia, Shqipëria dhe shqiptaria. Prandaj edhe ky bir i denjë e meriton atë çfarë flitet e shkruhet për të, Maman Saliu pasuroi historinë, duke e mbajtur gjallë atë me kujtimet e tij që janë një dritë e pashuar e së vërtetës. Ai ishte dhe mbeti burri i nderuar i pushkës dhe i penës, i gjallë mes të gjallëve. Filozofia popullore e kulturës së tij shprehet në atë që vetë Mamani thoshte “Të kaluarës t’i marrim zjarrin dhe jo hirin”, prushin që ndez zemrat e shpirtrat atdhetare në çdo kohë e çdo brez. Mamani ishte brez i brezit të hekurt, burrë

i stralltë, që fjala i peshonte rëndë, që hyri në “universitetin” e Bramyshjes së Tërbaçit, në BrV Sulmuese Partizane, që sfidoi vdekjen me trembëdhjetë plagë lufte, që copa predhash i kishte bashkëshoqëruese e bashkë udhëtare të jetës së tij, që s’u tut kurrë nga istikami, që jetën e jetoi me dinjitet dhe diti të përballonte çdo sfidë. Ashtu sikurse thoshte Ismail Skeja ish-Drejtor i Arkivit të MB-së më 15.5.2017 në “Maman Saliu, nderim komandantit trim”: “Nëna kalabreze kur i lind djalë ia kthen kokën nga Karaburuni dhe i thotë: Andej janë malet tona. Nëna vlonjate ia kthen kokën femijës nga Kalabria dhe i thotë: Gjaku ynë është dhe matanë këtyre brigjeve. Nënë Fatua, gruaja e Heroit Sali Vranishti, kur i lindi Mamani, djali i vetëm i saj, më 15.5.1922, ia ktheu kokën, jo vetëm nga Kalabria, por edhe nga Preveza, Shkodra, Kosova e Dibra, e gjithë shqiptaria”, domethënëse për familjet e mëdha aristokrate që për devizë kanë dashurinë për mëmëdheun.

Maman Saliu, koloneli i spikatur i Sigurisë Kombëtare me integritet të lartë atdhetar

Maman Saliu ishte lindur më 15 maj 1922, në Vranisht të Vlorës dhe është shuar më 3.2.2012. Ai erdhi në jetë në një truall mjaft



atdhetar, dhe përgjatë gjithë jetës justifikoi për çfarë ishte si biri i legendës atdhetare, luftëtare e patriote, biri i kapedan Sali Vranishtit. Mamani ishte figurë e spikatur e rezistencës antifashiste, por dhe e Sigurisë Kombëtare, pasi në jetë kishte edhe një armë më shumë: “pasurinë intelektuale”. Shkollën fillore e kreu në Vranisht, plotoren në Vlorë, ku vijoi edhe studimet në Shkollën Tregtare. Pushtimi fashist e gjeti Mamanin të burrëruar dhe që u përfshi që në fillim në lëvizjen antifashiste. Në korrik 1942, arrestohet për veprimtari politike dhe burgoset në Vlorë e Tiranë. Në 10.12.1942 është pjesë e njësiteve guerile të fshatit e krahinës, në maj 1943 përzgjidhet sekretar celule në Vranisht. Koha rrodhi shpejt dhe në gusht 1943, i besohet detyra e komandantit të çetës partizane që mbante emrin e babait të vet “çeta partizane Sali Vranishti”, më pas komisar çete në batalionin “Halim Xhelo”, komisar batalioni në BrVS. Gjatë luftimeve për mbrojtjen e Kongresit të Përmetit (24-28.5.1944) plagoset rëndë. Trembëdhjetë plagë lufte nuk e mposhtën dhe angazhohet në luftime deri në thellësi të tokave në Sanxhak, në ish-Jugosllavi, për çlirimin e tokave të vëllezërve tanë kosovarë. Pas çlirimit të vendit i ngarkohen përgjegjësi të larta në strukturat e Sigurisë Kombëtare. Në vitet 1951-1953 kryen arsimin politik, kurse në periudhën 1957-1961 vijon studimet e larta ushtarake në Akademinë “Xherxhinski” në Moskë, ndërkohë që në vitin 1961 shpallet “person non grata” nga qeveria sovjetike, me motivacionin: “Për qëndrim të hapur e të vendosur në mbrojtje të vijës zyrtare të shtetit shqiptar, përjashtohet nga diplomimi dhe cilësohet nga qeveria e BRSS “person non grata”. Deri në heqjen e gradave, më 1 maj 1966 ka mbajtur gradën ushtarake “kolonel”. Në vitin 1966, largohet vullnetarisht nga kryeqyteti dhe shkon në vendlindje, ku kontribuoi për dy dekada si veprimtar shoqëror në gjithë krahinën e Mesaplikut dhe Kurveleshit të Poshtëm. Ai ka qenë i zgjedhur anëtar i kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik dhe është vlerësuar me titullin e lartë “Personalitet i shquar i Labërisë”, por edhe me shumë urdhra, medalje e dekorata të akorduara nga Presidiumi i Kuvendit Popullor; gëzonte statusin e “Invalidit të LANÇ” me 13 plagë lufte, si pjesëmarrës me armë në dorë gjatë LANÇ-it, por edhe për shërbimin si oficer në strukturat e sigurisë së brendshme për 22 vite (1944-1966). Edhe pse është shuar më 3 shkurt 2012, në Tiranë, ka qenë dhe ka mbetur në memorien e brezave si një figurë e përjetshme në zemrën e kombit shqiptar, bir i një familje-oxhak me taban lab, por edhe bir i një kapedani meteor të Labërisë. Maman Saliu ishte dhe mbeti deri në fund të jetës së tij një personalitet, që me botimet e tij ia shtoi më shumë vlerat për të tre epokat që jetoi. Ai publikoi “Trokitje në kujtesë” më 2004, “Në vorbullën e jetës” më 2007, “Kujtime dhe mbresa”, 2022 e publikuar nga i biri Arben Saliu në 100-vjetorin e lindjes së babait të tij. Edhe sot dhe nesër do vijojë të këndohen vargjet e rapsodit

lab për Maman Saliun sikurse u kënduan dhe për Sali Vranishtin: “Malet e Vranishtit nxijnë,/Qajnë për Maman Salinë,/Qajnë për burrin e rëndë,/S’do ta shohin më në këmbë../Maman Sali Labëria,/Mbi supe të rri lavdia”. Nuk mund të mungonin në këtë shkrim për Maman Saliun, vargjet e përjetshme të mikut tim piluriot, Lefter Çipa: “Ai s’ndalet kurrë nga jeta,/ Ndaj t’i nderojmë burrërinë,/ Guximi i tij s’ndahet me feta,/Kush nuk ja njeh Historinë”. **Studenti ushtarak Maman Saliu përballë makinacioneve ruse në Moskë**
Nga radiogrami i Ambasadës Shqiptare në Moskë me nr.285, më datë 6.VI.1961, njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme në Tiranë se: “Komandanti i Shkollës së Lartë “F. Xherxhinski”, Gjeneral Koljankov, thirri përgjegjësin e studentëve shqiptarë Maman Saliun dhe e njoftoi se duhej të largohej nga territori i BRSS më 8.6.1961 pasi ishte përjashtuar nga shkolla me motivacion: “Nuk ka mbajtur qëndrim të drejtë në një seminar, është ankuar pse shtypi sovjetik nuk shkruan për Shqipërinë dhe si përgjegjës grupi ka lejuar që studentët të merren me politikë”. Përveç Maman Saliut, u përjashtua nga kjo shkollë dhe Thoma Duro, nga Shkolla e Sigurimit Politik Vangjel Xhixho, Malo Idrizi, nga Shkolla e Sigurimit në Leningrad u përjashtua Andrea Ndridhori. Marrëdhëniet politike kishin marrë fund me rusët vetëm se shqiptarët nuk nënshtroheshin. Nga informacioni Telegrafik i Ambasadës shqiptare në Moskë, nënvizohet: “Nisur nga kjo ngjarje, më 7.6.1961, Ambasadori i RPSH-së në Moskë, Nesti Nase, mori takim me zëvendësministrin rus Kuznecov dhe me porosi të Qeverisë sonë i shtroi çështjen e oficerëve tanë të përjashtuar nga shkollat ushtarake. Ambasadori jonë i vuri në dukje se nga ana e komandave të shkollave karshi ushtarakëve tanë janë bërë provokacione të ndryshme. Ai e quajti vendimin për përjashtimin e tyre nga shkolla si një masë për të mbuluar veprimtarinë e tyre jo miqësore kundër vendit tonë. Pastaj në emër të Qeverisë tonë kërkoi kthimin e gjithë ushtarakëve tonë të degëve të Sigurimit, Kufirit dhe Policisë në Atdhe”. Më 13.6.1961, kryetari i Degës të Ministrisë së Punëve të Jashtme të BS-së Astavin thirri ambasadorin shqiptar dhe i dorëzoi një promemorje të Ministrisë së Jashtme: “Kohët e fundit disa ushtarakë shqiptarë kanë bërë goditje armiqësore dhe shpifje kundër PK të BS dhe qeverisë sovjetike, kanë prishur disiplinën ushtarake, kanë injoruar komandat e shkollave, kanë shpifur mbi politikën e jashtme të B. Sovjetik, nuk kanë treguar kujdes për të mësuar historinë e PK të BS, kanë kërcënuar dhe ofenduar oficerët sovjetikë”. Në fund të promemories, thuhet se Ministria e Punëve të Jashtme të BS është e ngarkuar të deklarojë se këto veprime u sjellin dëm marrëdhënieve sovjeto-shqiptare...”(Arkivi i MPJ, Viti 1961, Dosja 42/10, fletët 26-28). Kokë shqiptari! Nuk e njihnin përkuljen dhe nënshttrimin dhe ky rebelim ka ndodhur shekujve kundër gjithë pushtuesve. Kjo

është pjesë e papërkulshmërisë dhe mosnjohjes dhe mosnënshttrimit, pasi sikurse thotë populli “e drejta zhytet por nuk mbytet”.

Përmbushës i idealeve të babait dhe përgjegjës përpara historisë Maman Saliu edhe pse ishte tre vjeç kur u shua legjenda e shqiptarizhmës, Sali Vranishti, kapedani kishte një përgjegjësi të madhe përpara historisë, të mbante lart si flamur një emër që respektohej e nderohej në çdo vatër me zemër shqiptare. Gjurmët e të atit, që luftoi kundër osmanlinjve, andartëve grekë, okupatorëve italianë, shovinistëve serbë dhe falangave që sollën Zogun në fuqi, një jetë e tërë në luftë, do ta ndiqnin kudo, pasi populli e kishte fiksuar figurën e babait të tij në vargjet lapidar: “Kapedan Sali Vranishti,/ Sa rroi, i punoi gishti”. Ndërkohë që Gazeta italiane “Epoka” e cilësonte Sali Muratin “Gjeneralissimi i rebelëve të Jugut”. Por kush ishte Sali Vranishti?

Sali Murati – Vranishti, një jehonë e kapedanëve nëpër shekuj Në memorien e shqiptarëve emri Sali Vranishti, i lindur Sali Murati, por i njohur si kapedan Sali Vranishti. Fakt është se është memorizuar si një atdhetar i flaktë dhe luftëtar i shquar për liri e sovranitet kombëtar. Sali Murati erdhi në jetë, më 20 mars 1880, në Vranisht të Vlorës. Si rebel ndaj osmanëve përndiqet, arrestohet tradhtisht dhe izolohet prej koshareve osmane në kështjellën e Janinës. Arratiset prej këtej i plagosur dhe qysh në fillim të shekullit XX fillon jetën e komitit. Me frymëzim të Ismail Qemalit në nëntor 1908, krijon çetë patriotike me luftëtarë nga Vranishti si dhe Lumi i Vlorës, të cilët i drejtoi me trimëri e heroizëm këtë çetë. Ai zhvilloi disa aksione në Labëri, në Vlorë e më gjerë. Në 1911 merr pjesë në mbledhjen e Drashovicës në mbështetje të Memorandumit të Gërçes. Aksioni më i bujshëm është ai i hapjes së burgut të Vlorës, më 24.8.1912, kur Sali Vranishti liroi gjithë të burgosurit, ngjarje që pati jehonë në shtypin vendas dhe atë të huaj. Në prag të shpalljes së pavarësisë, shkon në ndihmë të popullsisë të Delvinës dhe lufton ndaj bandave andarte greke. Më 28.11.1912 me krijimin e qeverisë të Ismail Qemalit, gradohet kapiten dhe emërohet komandant i Sigurimit Publik. Në krye të forcave atdhetare zmbraps rebelimin esadist kundër Qeverisë së Vlorës në Cakran dhe Myzeqe. Pas këtyre ngjarjeve plagoset, por nuk tërhiqet nga misioni atdhetar. Bashkë me Çerçiz Topullin organizojnë dhe drejojnë luftimet në mbrojtje të trojeve amtare nga andartët grekë dhe shovinistët e Jugut, ndërkohë që merr pjesë në Kuvendin e Shtëpëzit, më 10.4.1914, për të përballuar dyndjet andarte greke bashkë me Selam Musain, Çerçis Topullin, Sulo Beqirin, Bajram Ligun, Halil Sullon nga Fushëbardha e kapedanë të tjerë të Labërisë. Në vitin 1918, bën pjesë në shoqërinë patriotike “Opinga”. Në Luftën e Vlorës spikat për kontribut të jashtëzakonshëm. Plagoset rëndë gjatë sulmit për marrjen e kalasë së Kaninës. Gazeta italiane “Epoka” do ta cilësonte “Gjeneralissimi i rebelëve të Jugut”. Më 3 shtator 1920 me çlirimin e Vlorës, përfshihet në strukturat e sigurisë kombëtare. Në shtator 1920 merr pjesë në luftimet kundër pushtuesve serbë në Macukull dhe në Shkallë të Deshe në zonën e Matit. Aderon në shoqërinë “Bashkimi” dhe me fillimin e Revolucionit të qershorit udhëheq forca kryengritëse. Në Tiranë i besohen detyra në mbrojtje të Qeverisë së Fan Nolit. Me dekret të posaçëm, më 1.11.1924, Qeveria Demokratike, krahas Bajram Currit dhe Hysni Currit, nxjerr në pension edhe Sali Vranishtin me motivacionin e invaliditetit. Në dhjetor 1924, merr pjesë në luftimet në Shkallë të Tujanit kundër forcave të kombinuara zogisto-vrangaliste, ndërsa me triumfin e forcave revanshiste, në fund të muajit janar 1925, kthehet në vendlindje, pasi plagët në trup i kishte të pambyllura, të cilat i marrin jetën më 24.1.1926, në moshën 46 vjeçare, duke lënë bonjakë një vajzë dhe një djalë. Sali Vranishti mban titullin e lartë “Hero i Popullit” dhe eshtrat e tij prehen në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në Vlorë. Është vlerësuar gjithashtu me çmimin “Nderi i Qarkut Vlorë”. Një rrugë në Vlorë dhe një në Tiranë mbajnë emrin e tij. Në Vranisht ka një shtatore të derdhur në Bronz, por një shtatore e re është përgatitur nga artisti i popullit Muntaz Dhrami, nën kujdesin e nipit të tij Arben Maman Saliut. Në romanin “Ultimatum” të Petro Markos është personazhi qendror, ndërsa në popull, i madh dhe i vogël i njohin mirë vargjet: “Kapedan Sali Vranishti, Sa rrojti, i punoi gishti”. Më 25 gusht 1943, emrin e figurës së madhe popullore e mori formacioni partizan i çetës partizane të quajtur “Sali Murati”, në nder të tij. Komandant i kësaj çete ishte i biri i tij Maman Saliu.

Dritëro Agolli, Rrahman Parllaku dhe Shaban Sinani, për Maman Saliun:

Poeti ynë kombëtar Dritëro Agolli shprehet: “Po të lexosh me vëmendje kujtimet e Maman Saliut do të gesh se jeta e tij është pjesë e rëndësishme e historisë së Shqipërisë...Maman Saliu jo vetëm e pasuron historinë, por e mban atë gjallë”.

Gjenerali Rrahman Parllaku shkruan: “Maman Saliu hynte në kategorinë e atyre udhëheqësve që jo vetëm e jepnin komandën “para partizanë”, por që dilte vetë në ballë të luftimit... mori plagë të shumta dhe të rënda për të mbetur invalid përjetë. Megjithëse me plagë të pambyllura, ai nuk iu nda brigadës deri matanë kufirit shtetëror, duke treguar se ishte biri i denjë i kapedan Sali Vranishtit”.

Prof. Dr. Shaban Sinani shkruan: “Në kujtimet e tij, Maman Saliu shkruan për të pohuar shumë serbes se mund të pranojë çdo lloj gjykimi, për më tepër që koha e ka vënë në zgrip brezin e tij..., virtyti dhe ideali mbijetojnë. Kujtimet e Maman Saliut dëshmojnë se brezi i tij...përsëri do gjente strehë tek ideali”.

PROLOG

Hektor Eftim Lako, “Dëshmor i Atdheut”, 1929-1962

Atë ditë kur kaloi Vjosën së bashku me skuadrën partizane dhe doli malit për liri, ishte fillimi i vitit 1943. Hektori nuk i kishte mbushur ende 14 vjeç. Nëna e tij, Margarita, një grua e dhimbsur, me tipare burrërore, e ndoqi pas djalit e dytë, me lutjen që ai të kthehej në shtëpi, se partizan përpara tij kishte dalë vëllai i madh, Koçua dhe motra, Leonorë. Ajo, vetë ishte aktiviste e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në terren. Por, Hektori e kishte ndarë mendjen dhe vijoi udhën e të parëve; doli partizan e u bashkua me çlirimtarët.

Pas Luftës Çlirimtare, kur vendi u çlirua ai iu kthye shkollës, atje ku e kishte lënë e më pas u bë pilot. Djali i nënë Margaritës fluturonte në hapësirat qiellore, si zogjtë fluturakë. Nëna, në dejet e së cilës rridhte gjak atdhetari, kur mësoi planet e të birit, e bekoi atë me shpirt dhe i uroi: “Të qoftë udha e mbarë dhe e paç jetën të gjatë, bir-o!”.

Vitet rrodhën e nëna u lashtua. Hektori u bë burrë e shpalosi tiparet e një njeriu të gatuar prej brumi të veçantë. Nëna, e lodhur nga vitet dhe nga brengat, nuk e ndiqte dot të birin pilot, në udhët e qiellit ku ai shtegtonte përditë. Ajo e dinte se profesioni që zgjodhi i biri, ishte i mbarsur me rreziqe, në çdo hap, por nuk mund t’i thoshte atij: “Kthehu, bir-o!”. Nënë Margarita e priste djalit e dytë, t’i vinte në shtëpi, së bashku me bashkëshorten e tij, Filloretin, me një bebe në krah, por ai u kthye, siç ajo nuk do ta dëshironte kurrë. Nata e mallkuar e 23 marsit të vitit 1962, kur sedërliu Hektor Lako, fluturonte për të marrë klasin e dytë të pilotit, duke zbritur në aerodromin e Qytetit “Stalin”, u përplas me kodrat, ku humbi jetën. Komandanti i Skuadriljes së parë, simpatiku me zë bilbili, atë natë, nuk iu kthye familjes, si përherë.

Kur e pa të birin të pajetë, të rrethuar me nderim prej shokëve, kolegëve dhe vartësve të tij, të mbuluar me flamurin kombëtar, simbolin dhe nderin e shqiptarizms, me kapelën e bukur përsipër arkivolit të kuq, nënë Margarita bëri atë që ishte në nderin e saj, mblodhi veten, edhe pse dhimbja ishte e pamasë e u dha kurajë të sajve dhe gjithë atyre që ishin mbledhur për ta përcjellë Hektorin. Të gjithë ishin të tronditur e të shokuar nga ky “kurth” që kishte rezervuar jeta. Nëna e përcolli të birin, duke derdhur mbi atë vend të “shenjtë” më tepër lot se dhe. Ajo, sa ishte gjallë, e ruajti 4 vjet me radhë një varr për Hektorin, përbri vendit që kishte porositur për vete dhe e solli të birin, në Tiranë, në vitin 1968.

E donte ta kishte pranë të birin, si atëherë kur e kishte të vogël dhe e pushtonte në krahët e saj, me afshin e nënës, që të mos i ftohej kur flinin. Mirëpo “shtegtimi” i Hektorit, edhe i pajetë, nuk kishte të sosur. Ai gjeti qetësi vetëm atje, në kodrën përmbi Tiranë, ku prehen shokët e tij të Luftës dhe kolegët e fluturimit. Atdheu i mblodhi tok, si dikur, në Luftën Çlirimtare dhe kur fluturonin nëpër llogoret qiellore të Atdheut. Ata janë në piedestalin e nderit, atje ku u takon të prehen, me lavdinë që i ka mbuluar, përjetësisht. Hektori ka pranë Niko Hoxhën, Azbi Seranaj, Bego Hoxhën, Luto Sadikaj, Idriz Hoxhën etj., ata trima, me fletë që i dhuruan Shqipërisë jetë nga qenia e tyre. Ashtu, krah për krah, atyre u duket sikur marshojnë, së bashku, në të njëjtën llogore e në të njëjtin formacion luftarak, si dikur. Me veprën e tyre heroike, sot e sa të jetë jeta, do të krenohet mbarë Shqipëria e cila uron: “E paçin të përjetshme lavdinë e u kujtofshin në përjetësi!”

Jeta dhe veprimtaria e Hektor Eftim Lakos

Hektor Lako, u lind në fshatin Leusë të rrethit të Përmetit, më 11 qershor të vitit 1929, nga dy prindër shqiptarë, atdhetarë të shquar, pinjollë të lindur në një truall të begatë e të spikatur, për atdhetari e shqiptarizëm. Eftimiu, babai i Hektorit ishte arsimtar, i shkolluar në Selanik të Greqisë. Pas titullimit mësues, ai u caktua të jepte mësim në shkollat e fshatrave, Bënjë, Kosinë e Leusë dhe në qytetin e Përmetit. I formuar me dashuri për Shqipërinë dhe për gjuhën e bukur amtare, Eftimiu, i mëkoi nxënësit e tij, të cilët i trajtonte si fëmijët që kish në vatër, me dashurinë për çdo gur e për çdo shkurre të trojeve të të parëve, me dëshirën për të mësuar e për të folur gjuhën e shqipfolësve dhe me respektin e ndërsjellë, për njëri-tjetrin, si tipar dallues i përmetarit.

Nga lidhja martesore mes Eftim Lakos me Margaritën e At Staf Melanit, erdhën në jetë pesë fëmijë, Koçua, Leonora, Hektori, Arqilea dhe Ylli. U formua një çerdhe e vërtetë atdhetarie, ku vlonte dëshira për ta parë vendin të lirë e të begatë, në të cilin njerëzit të flisnin e të shkruanin lirshëm gjuhën e bukur Shqipe, të lëvruar aq bukur e me shumë dashuri, nga Frashërlinjtë mendjendritur e Atdhetarë.

Sipas të thënave të Arqile Lakos, vëllai i Hektorit, shtëpia e tyre, në Leusë, për shkak të qëndrimeve të pjesëtarëve të saj kundër



pushtimit të vendit, ishte shtëpia e parë në rrethin e Përmetit, e cila u dogj egërsisht nga fashistët italianë. Të mbetur pa strehë, xha Eftimi dhe nënë Margarita, i çuan fëmijët dhe atë pak katandi që mbeti nga shkumbimi mizor, në shtëpinë e bashkëfshatarit të tyre Dhionisit, i cili nuk u kërkoi as shpërblim, për qëndrimin në shtëpinë e tij. Siç kujton Arqilea, shtëpia e familjes Lako, në Leusë, para se të digjej, nga fashistët, ishte, në mes të fshatit dhe me dy kate. Shtëpia prindërore, ku u lind Hektori, ishte me çati të mbuluar me plloça guri bojë gri dhe muret i kishte prej guri, të lidhur me llaç gëlqere e me breza druri. Hektor Lako, fëmijërinë e kaloi në fshatin e lindjes, në Leusë, në gjirin e familjes, ku u mëkua me edukatë morale të shëndoshë e me kulturën autentike që sundonte në mjediset përmetare. Në Leusën e tij të dashur e të bukur, ai mori mësimet e para, njohuritë për botën dhe për njerëzit e mirë të trevës. Në ato vite, shkolla e fshatit, në Leusë dhe më gjerë ishte sipas sistemit me katër klasë. Hektori i mori mësimet e para, nga mësuesi Spiro Izgari, i cili ishte lindur në qytetin e Përmetit. Mësimi i Historisë Përmetare, me heronjtë e shumë të saj, në fushën e Atdhetarisë, ku pikë referimi ishte dhe gjyshi i tij, At Staf Melani dhe njerëzve të mëdhenj, dishepuj të dijes e të kulturës e mbrujtën djalit e ri me krenarinë e ligjshme

për Përmetin e bukur, për traditat e shkëlqyera të krahinës, për qenien përmetar.

Meqenëse klasa e katërt ishte më e larta në fshat, prindërit arsimdashës të tij, e çuan djalit e zellshëm në mësimet, të vazhdonte e të mbaronte klasën e pestë, në qytetin e Përmetit. Ai mësoi më shumë e mori kulturë më të gjerë, në shkollën e “Shën Kollit”, e cila ndodhej pranë kishës me të njëjtin emër. Hektori shkonte në shkollë, me shumë dëshirë e ishte i vëmendshëm në mësimet. Ai e përfundoi shkollën me tregues të “shkëlqyer”. Hektori, ende fëmijë, kishte prirje për lëndët ekzakto dhe i pëlqente kënga. Ai këndonte në shkollë, në familje e në mjedise të tjera, me zë të qartë, të lartë e të bukur. Hektori ishte një artist i lindur! Në familjen Lako, këndonin me zë të qartë, të lartë e të bukur, të gjithë pjesëtarët e saj. I ati, Eftimiu, Koçua, mamaja, motra, Arqilea, dhe Hektori, këngën e kishin dhunti, pasion dhe trashëgim. Burimin e frymëzimit, Hektori e merrte nga natyra e bukur përmetare, nga bëmat e njerëzve të shquar të trevës dhe e kishte në gen. Ai këndonte në shtëpi, në shkollë e në rrugë; në çdo kohë e në çdo vend. Kur mblidheshin të gjithë pjesëtarët e familjes Lako, ia thoshin këngës përmetare. Ai që dëgjonte këngën e tyre, kënaqej, me atë “simfoni” të rrallë. Këngë të preferuar kishin atë që i bënte

jehonë atdhetarisë të At Staf Melanit, të cilin e kishin gjysh, nga mamaja, këngët përmetare, si: “Falma synë e zi”; “Trëndafil fletë-fletë”; “O borzilok” etj. Edhe nëpërmjet teksteve të këtyre këngëve me theks atdhetar, Hektori gjente burimin e frymëzimit, gjë që e burrëronte atë, dita-ditës.

Tek piloti i ardhshëm Hektor Lako, fëmijëria erdhi me karakteristika të veçanta. Ai, edhe kur ishte akoma i parritur, kaloi me sukses disa “teste trimërie”. Nëna e tij, Margarita, një grua me tipare burrërore, nënë e dhimbsur, por dhe e rreptë, për ta vënë në provë djalin e saj çapkën, Hektorin, e dërgonte, në mes të natës, të vetëm, në stan, tek çobanët që rruanin bagëtitë, i cili ndodhej larg shtëpisë e jashtë fshatit, me porosi të rëndomta. Nga verifikimi që ajo bënte të nesërmen, duke pyetur barinjtë e tufës, Nëna bindej se Hektori e kishte kryer porosinë. Si shumë nga moshatarët e tij, Hektori ngjitej në pemët e larta e të vështira, me arra ose në caracët, buzë përroit, fruta të cilat nuk i kishte në oborrin dhe në kopshtin e familjes. Ai, si guximtar, u ngjitej më lart pemëve, se shokët e tij. Hektori e shpaloste guximin edhe kur “i binin në qafë”. Ai përleshej, jo vetëm me moshatarët por dhe me të tjerë, në moshë më të rritur e më të fuqishëm se ai.

Hektori, u formua si djalë me edukatë të shëndoshë, i dashur e i shoqërueshëm me moshatarët e tij dhe me humor të këndshëm. Ai nuk i duronte padrejtësitë dhe në raste të veçanta shfaqej rebel e i sertë. Shtëpia e Eftim dhe Margarita Lakos, në Leusë të Përmetit, pavarësisht se u dogj e u shkrumbua nga fashistët, fatin e të cilës e ndoqën më pas edhe mjaft shtëpi të tjera në trevë, mbeti një bërthamë e shëndoshë shqiptarie. Edhe kur banonin në shtëpinë e bashkëfshatarit të tyre, bujaria karakteristike përmetare shkëlqeu e u shpalos në ato ditë të vështira të pushtimit e të luftës për liri. Dera e familjes Lako, priste e përcillte, me nderime, jo vetëm miqtë e shumtë të saj dhe të fisit, por dhe luftëtarët e lirisë. Ajo ishte e hapur 24 orë në ditë, për njerëz të thjeshtë, të mirë e sidomos për ata që kishin të njëjtët ideale. Në atë derë ziente në çdo kohë biseda rreth Luftës Çlirimtare. Tema e Luftës për liri ishte temë e ditës; ajo prevalonte bisedat me tema të tjera. Në pranverën e vitit 1943, në shtëpinë e xha Eftimit, trokiti një partizan, të cilin e pasonte një skuadër luftëtarësh të lirisë. Për njerëzit e Luftës Çlirimtare, ajo shtëpi ishte e preferuar dhe e sigurt. Në mal, partizan i orëve të para, ishte vëllai i madh i Hektorit, Koço Lako dhe motra Leonorë. Babai dhe nëna e Hektorit, ishin aktivistë në terren. Prandaj në atë çerdhe lufte për liri, partizanët hynin e dilnin si në shtëpinë e tyre.

Partizani që trokiti në derë, ishte komandant i një skuadre të shkëputur nga formacioni luftarak i Brigadës së Parë Sulmuese të Ushtrisë Nacional Çlirimtare. Në armatimin e këtij njësiti partizan ishte një top i çmontueshëm, të cilin e përdorte vetëm komandanti i skuadrës. Ai ishte nga Korça dhe quhej Lluca Misha. Skuadra partizane kishte me vete dhe 3-4 mushka trupmëdha italiane, të cilat i përdornin për ngarkesë. Partizani Lluca kishte me vete një kitarë dhe, në kohën e lirë, këndonte serenata korçare e këngë atdhetare, të shoqëruara nga tingujt e instrumentit të tij.

Skuadra partizane, me komandant Llukën erdhi në shtëpinë e familjes Lako 3-4 herë. Hektori dhe Lluca u miqësuan njëri me tjetrin edhe si këngëtarë. Të dy pëlqenin këngën dhe këndonin bukur. Kënga atdhetare dhe partizane e ndezi më shumë atmosferën dhe frymën luftarake tek pjesëtarët e familjes Lako. Një ditë, skuadra partizane mori urdhër të kalonte Vjosën, të hidhej në Veri të saj dhe të bashkohej me njësinë të cilës i përkiste. Hektori, në atë kohë nuk i kishte mbushur të katërmbëdhjetë vjeçët por ishte mjaft i shkathët, shtatlartë e çapkën. I mikluar dhe nga fakti që komandanti i skuadrës partizane ishte këngëtar i mirë e i binte kitarës, ai e ndoqi pas gjurmëve skuadrën partizane që po ikte, e mbërriti para se ajo të kapërcente lumin dhe, tok me partizanët, kaloi në Veri të Vjosës. Në rrethana disi të veçanta për të, akoma i parrituri i nënë Margaritës, u bë pjesë e skuadrës partizane dhe nuk iu nda asaj, në kundërshtim me kundërshtimin e Llukës dhe me lutjet e nënës, e cila e ndoqi skuadrën pas dhe i lutej Hektorit të kthehej. Ajo, meqenëse dy vetë nga familja e tyre ishin në mal dhe vetë Nëna, së bashku me xha Eftimin ishin aktivistë të lëvizjes çlirimtare, në terren, mendoi se i biri, nuk ishte rritur akoma për të dalë në mal dhe se veprimtaria atdhetare në Leusë e në krahinë ishte e ndezur. Megjithatë Hektori sedërli, nuk lëvizi nga vendimi që kishte marrë dhe doli partizan.

Viti 1943, kur Hektor Lako, 14 vjeçar u rreshtua në formacionet partizane ishte kohë e vërshimit të luftëtarëve të lirisë, në formacionet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare partizane dhe e luftimeve të ashpra kundër pushtuesve nazistë. Hektori, pas shumë përpjekjeve e kërkimesh, e gjeti dhe u bashkua me të vëllanë e madh, Koço Lakon, i cili ishte jo vetëm më i madh në moshë por dhe partizan i regjir, me përvojë të gjatë luftimesh. Koçua ishte partizan i Brigadës së Tetë të Ushtrisë Nacional Çlirimtare. Për vëllain, pas tij në radhë, Hektorin, Koçua ishte një lloj “këshilltari” dhe kujdestari, të cilit i përcolli eksperiencën e tij në luftime e në jetën partizane. Kur ndodhej në Poliçan, Brigada e tetë u rrethua nga forcat gjermane, të cilët në një luftim kapën rob 5-6

partizanë, me moshë si të Hektorit dhe i pushkatuan. Hektori, me shkathtësinë tipike që kishte, për të mos rënë në duart e armiqve, kaloi prapa një bregoreje dhe shpëtoi. Pushtuesit nazistë, e kishin piketuar familjen Lako, si çerdhe e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, për ta internuar, në kampet e përqendrimit në Gjermani. Komanda e Vendit, ku bënëin pjesë dhe xha Eftimiu nënë Margarita dhe Arqilea adoleshent, e çuan këtë familje në Sheperin malor, ku ishte vend i sigurt për ta. Hektori, vëllai i madh, Koçua dhe motra Leonorë qëndruan në radhët partizane e luftuan, trimërisht, deri në çlirimin e plotë të vendit.

Fillimi i vitit 1945, e gjeti Hektorin, si shumë ish-partizanë të moshës së tij, në bankat e Shkollës së Kadetëve, e cila sapo ishte hapur. Meqenëse Hektori, para se të dilte partizan, kishte kryer pesë klasë të shkollës qytetëse, sipas programit të asaj kohe, i vijoi mësimet, atje ku i kishte lënë, me programin e ri. Më 1 prill të vitit 1945, Hektori dhe shokët e tij, ish-partizanë nisën mësimin e rregullt në këtë shkollë. Ishin bërë përpjekje të shumta, për të gjetur mësues të lëndëve të ndryshme, mbasi, siç dihet, niveli arsimor e kulturor i popullatës, në atë kohë ishte mjaft i ulët dhe rrjeti i shkollave që përgatitnin mësues ishte i kufizuar vetëm me Normalen e Elbasanit.

Në orën e parë të mësimit, kur djemtë e kthyer nga mali ishin ulur në bankat e shkollës, në klasë u fut mësuese Kadrie Kopliku, një zonjë grua, e mençur e me kulturë, nga qyteti i Shkodrës. Ajo do të drejtonte mësimin e historisë. Pas saj në klasë u fut mësuesi i gjuhës, Selam Tafaj, nga Tirana, e kështu me radhë mësuesit e tjerë. Thuajse të gjithë mësuesit kishin kryer studimet në shkollat perëndimore e ishin pajisur me kulturë Oksidentale. Kadetët, ishin me uniformën që kishin dalë nga lufta dhe qëndronin 24 orë me armatimin personal në krah. Në ditët e para të korrikut, të vitit 1945, Komandanti i Përgjithshëm urdhëroi që kadetët të dorëzonin armatimin personal, në depon e shkollës.

Në Shkollën e Kadetëve u krijua një situatë jo aq e këndshme, ish-partizanët i kishin mbajtur pranë vetes disa vite me radhë armët e tyre, ishin rritur e burrëruar me to, ishin mbrojtur e kishin sulmuar armikun. Arma, për ta ishte shndërruar si një pjesë e trupit e ishte bërë mjaft e dashur. Ndarja prej armës ishte si të ndaheshe nga një njeri i afërt e i dashur, siç janë pjesëtarët e familjes. Dikush që e ka përjetuar atë skenë, tregon se i vështroje kadetët, të mbledhur galuc, nëpër cepa, të vetmuar, të menduar e të përlotur, tek puthnin armën, përpara se ta dorëzonin atë në depon e shkollës. Shoku i grupit të mëvonshëm të Hektorit, trimi i rrallë Refit Jazoj, i cili ruante nën jastëk dy bomba, nuk i dorëzoi ato, por u hoqi siguresën e i hodhi në oborrin e shkollës. Ishte urdhri i Komandantit të Përgjithshëm, autoriteti i tij i padiskutueshëm që e futi në hullinë e domosdoshme dorëzimin e armëve prej kadetëve.

Pas dorëzimit të armëve personale, kadetët mësuan të mbanin në duar libra, fletore e lapsa, të cilët u shërbenin për procesin mësimor. Ata do të armatoseshin me dije e do të merrnin njohuri shkencore, e cila do t’u nevojitej për të shaluar tanke, anije lufte, aeroplanë të tipave të ndryshëm dhe mjete të tjera lufte, aq të domosdoshme për të modernizuar mbrojtjen e vendit të dalë nga lufta çlirimtare. Më 10 korrik të vitit 1945, u zhvillua një paradë ushtarake. Kadetët, parakaluan me kuadrate. Hektori ishte me



PARTIZANI QË TROKITI NË DERË, ISHTE KOMANDANT I NJË SKUADRE TË SHKËPUTUR NGA FORMACIONI LUF-TARAK I BRIGADËS SË PARË SULMUESE TË USHTRISË NACIONAL ÇLIRIMTARE. NË ARMATIMIN E KËTIJ NJËSITI PARTI-ZAN ISHTE NJË TOP I ÇMONTUESHËM, TË CILIN E PËRDORTE VETËM KOM-ANDANTI I SKUADRËS. AI ISHTE NGA KORÇA DHE QUHEJ LLUKA MISHA. SKUADRA PARTIZANE KISHTE ME VETE DHE 3-4 MUSHKA TRUPMËDHA ITALIANE, TË CILAT I PËRDORNIN PËR NGARKESË. PARTIZANI LLUKA KISHTE ME VETE NJË KITARË DHE, NË KOHËN E LIRË, KËNDONTE SERENATA KORÇARE E KËNGË ATDHETARE, TË SHOQËRUARA NGA TINGUJT E INSTRUMENTIT TË TIJ.

trup të derdhur e i shkathët. Ai u bë pjesëtar i kësaj parade, në kuadratin e kadetëve të veshur me tesha partizane. Ai parakaloi denjësisht, siç i kishte hije. Pas paradës, kadetët shkuan me leje, pranë familjeve dhe Hektori shkoi në Leusë, pranë prindërve dhe vëllezërve të tij. Rugëtimi për në familje ishte tejet i gjatë, 12-14 orë, nëpërmjet një rruge të dëmtuar vende-vende, nga lufta, me një “satë” nga ato që i ishin marrë shtetit italian, në kuadrin e reparacioneve të luftës ose që kishin mbetur në vendin tonë, si mbeturina të fashizmit. Rruga automobilistike, tërë gropa dhe e pa shtruar, kalonte nga qyteti i Beratit, ngjitej në një terren malor, të vështirë, nga Ballabani, Këlcyra dhe si pikë të fundit kishte qytetin e Përmetit.

Në vitin 1946, komisar i shkollës tashmë “Skënderbej”, u emërua Koço Lako, vëllai i madh i Hektorit. Në një farë mënyre, si dje, në luftë, edhe tani, pas saj, “kujdestaria brenda familjes”, e Koços për të vëllain, vazhdoi. Urtësinë, thjeshtësinë, kujdesin, pse jo, dhe dashurinë që shpaloste komisar Koçua, për skënderbegasit, e përjetoi dhe i vëllai, të cilin e donte dhe e çmonte mjaft. Në atë vit, në shkollën “Skënderbej” erdhën disa oficerë të rinj, për të drejtuar dy batalionet që u formuan, me nga 2-3 kompani. Mes oficerëve të rinj që u caktuan në shkollë ishin, Rexhep Rama, Sabri Godo, Jorgji Papagjini, Petrit Gaxhi, Enver Shehu etj. Në fund të vitit 1946 e në fillim të vitit 1947, Shkolla “Skënderbej” u shndërrua në një repart ushtarak, me detyrë luftarake, e përbërë nga djem që e mbanin lart frymën e Luftës Nacionalçlirimtare.

10 korriku i vitit 1947, i pajisi skënderbegasit ish-partizanë me dekoratat që kishin fituar në luftën partizane. Hektori, si mjaft nga shokët e tij, i cili ishte dalluar në luftime, për guxim e trimëri, u dekorua me urdhra e medalje lufte, të cilët ia zbkuruan gjoksin dhe ia shtuan krenarinë, atij djali çapkën e simpatik. Sa shumë u gëzuan familjarët e tij, kur e panë Hektorin, pranë tyre, në atë verë, me gjoksin plot me dekorata. E kishte ëndërruar nënë Margarita, t’i kthehej djali i dytë, si dhe dy fëmijët e saj, më të rritur, nga lufta çlirimtare ku u nis, me kokëfortësi e këmbëngulje, fitimtar e me lavdi dhe ia mbërriti asaj dite.

Më 6 mars të vitit 1948, në mjediset e shkollës “Skënderbej”, qarkulluan fjalë se, në vijim të dërgimit të studentëve për specializim në shkollat ushtarake të Lindjes, e pikërisht në Bashkimin Sovjetik, do të niseshin për studime, jashtë vendit, disa skënderbegas. Atë ditë, në kinemanë e shkollës u mblodhën shumë skënderbegas. Kapiteni Ilo Trebicka, ish-partizan, i dërguar nga sektori i kuadrit i Ministrisë të Luftës, lexoi emrat e skënderbegasve që do të shkonin për studime në Bashkimin Sovjetik. Për shkak se marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ndërpartiake mes Jugosllavisë dhe vendit tonë kishin marrë tatëpjetën, specializimi i ushtarakëve do të vijonte në shkollat sovjetike. Kapiteni Ilo Trebicka edhe më parë kishte lexuar të tilla lista përpara skënderbegasve, prandaj ata nisën ta thërrisnin kapitenin, me nofkën: “Oficeri i listave”.

Të mbledhur në kinemanë e shkollës, skënderbegasit i mbanin sytë tek dosja me fjongo të kuqe që shpalosi kapiten Iloja, në pritje, me frymë të mbajtur, leximin e emrave. Djemtë ushtarakë u qetësuan vetëm kur dëgjuan emrat e skënderbegasve: Bajram Hitaj, Elmaz Hasamataj, Riza Ramadani, Gani Selami (Gjondedaj), Flamur Mickaj, Qemal Mërtiri, Hektor Lako, Refit Jazoj, Lulo Musai (Spahaj), Shaqo Hoxha, të cilët do të niseshin në ditët që vinin, për t’u bërë pilotë, në shkollat sovjetike të aviacionit. Po merrte udhë një ëndërr e vjetër e Hektor guximtarit, për t’u bërë shok me zogjtë e qiellit.

Në mëngjesin e datës 7 mars, të vitit 1948, në orën 09.00, Hektori, së bashku me shokët e tij të grupit të aviatorëve të ardhshëm, me një aeroplan transporti të Ushtrisë Sovjetike, u nisën nga aerodromi i Tiranës (Laprakë) dhe brenda ditës mbërritën në Moskë; pas një qëndrimi të shkurtër, në Budapest e në Lvov. Në këtë aeroplan ishin dhe dhjetë skënderbegas, të cilët ishin caktuar të ndiqnin studimet në shkollat sovjetike të ndërlidhjes.

Më 12 prill të vitit 1949, kursantët kryen fluturimin e parë, me karakter njohës. Në kabinën e parë të avionit bombardues UT-2, ishte ulur Hektori; në të dytën, instruktori i tij, piloti sovjetik, metodisti i fluturimeve Mitronov. Fluturimi i parë ishte prezantues dhe zgjati rreth 15 minuta. E kishte ëndërruar, djali nga Leusa, këtë fluturim dhe e kishte përgatitur veten, për ta përballuar atë. Qëllimi i kësaj ngritje të parë ishte që Hektori, si të gjithë shokët e tij, të njiheshin me ajrin; të përjetonin “sjelljen” e avionit, në çaste e në pozicione të ndryshëm fluturimi si: ecja nëpër tokë, ngritja, marrja e lartësisë, ngjitja në lartësinë e caktuar, kthesat, në të dyja anët. Në këtë fluturim dhe në të tjerët që pasuan atë, kursantët, dita-ditës, gradualisht, përvetësuan elementët e fluturimit dhe në javën e parë të korrikut 1949, njëri pas tjetrit u lëshuan në fluturime vetëm. Vendin e instruktorit, në fluturimet vetëm e zinte një thes me rërë, pesha e të cilit ishte e përafërt me atë të instruktorit. Kjo masë është përdorur deri vonë, si në shkollën sovjetike të aviacionit dhe ne atë të vendit tonë, pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Ky ishte fillimi i rugëtimit të pilotit nga Përmeti, të cilit shumë shpejt do t’i ndërpritej fluturimi në mes, për t’u kujtuar me respekt dhe nder nga brezat që vijnë pas.

I përjetshëm kujtimi i tyre!

Katastrofa e re natyrore

Që nga kohërat më të hershme, fjala ‘nxehtë’ është përdorur për të përshkruar temperaturën dhe ne e kemi dëgjuar këtë fjalë shumë kohët e fundit në shumë pjesë të botës, duke pasur parasysh valët e vazhdueshme të të nxehtit. Më shumë se 61,000 njerëz vdiqën në vitin 2022 për shkak të valëve të të nxehtit që përfshiu kontinentin evropian.

